



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË APELIT  
D U R R Ë S**

Nr \_\_\_\_\_ Prot.

Durrës, më 23.02.2017.

**ANALIZA VJETORE**

*e*

**Prokurorisë Apelit Durrës Për vitin 2016**

Prokurorët e Prokurorisë Apelit Durrës, gjatë vitit 2016 kanë ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësimin në gjykimim e çështjeve penale në shkallë të dytë, duke përballuar një volum të konsiderueshëm pune, kryesisht të çështjeve me objekt gjykimin e themelit të çështjeve.

Në vitin 2016 janë regjistruar dhe gjykuar gjithsej 1499 1425 çështje penale të regjistruar gjatë këtij viti dhe 75 çështje të mbartura nga viti i kaluar. Nga të cilat 1232 çështje i përkasin fajësisë, cilësimit ligjor, llojit e masës dhe alternativave të dënimit, kundërshtimit vendimeve të prokurorit etj., dhe 267 çështje me objekt vleftësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi. Referuar treguesve në raport me vitin 2015, vit në të cilin janë gjykuar gjithsej 1558 çështje.

Në vitin 2016 ka përfunduar gjykimi për 1462 çështje nga të cilat 1195 çështje me objekt fajësisë, cilësimit ligjor, llojit e masës dhe alternativave të dënimit, kundërshtimit vendimeve të

prokurorit etj., dhe 267 çështje me objekt vleftësim, caktim dhe zëvendësim mase sigurimi.

Nuk ka përfunduar gjykimi për 37 çështje themeli të cilat kryesisht janë planifikuar për gjykim në muajin dhjetor 2016, ndërsa numri i çështjeve të mbartura në raport me vitin 2015 gati është përgjysmuar, në vitin 2015 ishin mbatur 75 çështje.

Krahasuar me vitin 2015 ngarkesa e përgjithshme është e pothuajse e njëjtë me tendencë ulje të numrit të çështjeve me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, treguesit krahasues paraqiten si më poshtë;

#### Çështjet e gjykuara gjatë vitit 2015

2015	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk në themel	1230	632	508	90
Masa sigurimi	328	171	139	18
Ank. Pandeh.	1087	515	481	91
Ank. Prokurori	471	283	171	17
Totali	1558	803	647	108

#### Çështjet e gjykuara gjatë vitit 2016

2016	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk në themel	929	512	366	51
Masa sigurimi	267	151	101	15
Lirim me kusht	33	7	23	3
Gjykim të tjera	270	128	109	33
Totali	1499	798	599	102

Për vitin 2016, të ndara sipas rretheve gjyqësore, rezulton se 798 çështje i përkasin rrethit gjyqësor Durrës, 599 çështje rrethit gjyqësor Elbasan dhe 102 rrethit gjyqësor Kavajë. Ngarkesa e çështjeve për prokuroritë e rretheve gjyqësore Durrës dhe Kavajë është pothuajse e njëjtë ndërsa rezulton me rënie prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Treguesit analitik sipas rretheve gjyqësore, llojit të objektit dhe subjektit ankimes paraqiten sipas tabelës së mëposhtme;

### Cështjet e gjykuara gjatë vitit 2016

2016	Gjithsej	Durrës	Elbasan	Kavajë
Gjyk them e objek tjera	1232	647	498	87
Masa sigurimi	267	151	101	15
Ank. Pandeh.	1151	602	468	81
Ank. Prokurori	348	196	131	21
Totali	1499	798	599	102

Cështje me objekt gjykimin e themelit çështjes ; Janë bërë objekt gjykimi i themelit të çështjeve gjithsej 1232 çështje, të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin 647 rrethit gjyqësor Durrës, 498 rrethit gjyqësor Elbasan dhe 87 rrethit gjyqësor Kavajë. Për këto çështje rezulton se në 1151 raste ato kanë ardhur për tu gjykuar në shkallë të dytë mbi ankimin e të pandehurve/mbrojtësve dhe 348 raste mbi ankimin e prokurorëve.

Nga këta tregues rezulton se kundërshtimi i vendimeve gjyqësore të gjykatave të shkallës parë është bërë në mbi 2/3 e çështjeve nga të pandehurit, ndërsa kundërshtimi i prokurorëve, raport ky i cili ka ndryshim me vitin e mëparshën pasi është rritur numri i çështjeve të kundërshtuara nga të pandehurit si dhe është ulur numri i rasteve të kundërshtuara nga ana e prokurorëve.

**Për rrethin gjyqësor Durrës** rezulton se janë gjykuar gjithsej 798 çështje penale, 647 çështje themeli dhe 151 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Raporti si subjekte ankuese rezulton se nga të pandehurit është ushtruar ankim në 602 raste ndërsa nga ana e prokurorit vetëm në 196 raste. Nga 647 çështje themeli, 492 kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të pandehurve, ndërsa 155 çështje mbi ankimin e prokurorit. Ndërsa për 151 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, të kësaj prokurorie, 110 raste kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të dyshuarve/pandehurve, ndërsa në 41 raste mbi ankimin e prokurorit. Nga treguesit e mësipërm rezulton se rreth 55 % e çështjeve i përkasin kësaj prokurorie, numri i çështjeve për këtë rreth gjyqësor është i lartë, krahasuar me vitin 2015 rezulton se janë gjykuar 803 çështje. Në përgjithësi dhe jo vetëm për këtë rreth gjyqësor, rezulton problematikë se nuk kërkohet aplikimi i dënimeve alternative edhe kur janë rastet e parashikuara nga nenet 59 dhe 63 të k.penal.

**Për rrethin gjyqësor Elbasan** rezulton se janë gjykuar gjithsej 599 çështje penale, 498 çështje themeli dhe 101 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Raporti si subjekte ankuese rezulton se nga të pandehurit është ushtruar ankim në 468 raste ndërsa nga ana e prokurorit vetëm në 131 raste. Nga 498 çështje themeli, 383 kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të pandehurve, ndërsa 115 çështje mbi ankimin e prokurorit. Ndërsa për 101 çështjet me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, të kësaj prokurorie, 85 raste, çështje kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të dyshuarve/pandehurve, ndërsa vetëm 16 raste mbi ankimin e prokurorit. Nga treguesit e mësipërm rezulton se numri i çështjeve për këtë rreth gjyqësor është në rënie, pasi gjatë vitit 2015 janë gjykuar 647 çështje. Ankimet e ushtruara nga të pandehurit zënë rreth 2/3 e totalit ankimeve, të njëjtët tregues paraqiten edhe për çështjet me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi.

**Për rrethin gjyqësor Kavajë** rezulton se janë gjykuar gjithsej 102 çështje penale, 87 çështje themeli dhe 15 çështje me objekt vleftësim dhe caktim mase sigurimi. Nga 87 çështje themeli, 68 kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të pandehurve, ndërsa 19 çështje mbi ankimin e prokurorit. Nga 15 çështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi, të kësaj prokurorie, 13 raste kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të dyshuarve, pandehurve dhe vetëm 2 raste mbi ankimin e prokurorit. Nga treguesit e mësipërm rezulton gati e njëjta ngarkesë.

Cështje me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi ; Ka përfunduar gjykimi i 267 çështjeve me objekt gjykimin e ankimeve të palëve për vleftësim, caktim e zëvendësim mase sigurimi, nga të cilat kanë ardhur për gjykim në shkallë të dytë 208 raste mbi ankimin e të pandehurve dhe 59 raste mbi ankimin e prokurorit.

Të ndara sipas rretheve gjyqësore rezulton 151 çështje i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 101 çështje i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe vetëm 15 çështje çështje i përkasin Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë. Për këto çështje rezulton se është kundërshtuar vendimi i gjykatës nga prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës në 41 raste, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Elbasan në 16 raste si dhe prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë në 2 raste. Konstatohet se numri i çështjeve të gjykuara gjatë vitit 2016 për çështjet me objekt vleftësim e caktim mase sigurimi rezulton në rënie, pasi gjatë vitit 2015 janë bërë objekt gjykimi 328 çështje, rënie sidomos konstatohet për Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Cështjet e gjykuara mbi ankimin e prokurorit; Gjatë vitit 2016, mbi ankimin e prokurorëve të prokurorive të shkallës parë, janë gjykuar gjithesej 348 çështje nga 471 çështje që janë gjykuar në vitin 2015. Ndonëse numri i ankimeve është më i

ulët, rezulton se numri i ankimeve të pranuar nga Gjykata e Apelit rezulton të jetë më i lartë, cka tregon për rritje të vlerësimit dhe nivelit profesional e ligjor të ankimeve të ushtruara nga prokurorët. Të ndara sipas rretheve gjyqësore, rezulton se 196 çështje, ankime i përkasi Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 131 çështje, ankime Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 21 ankime Prokurorisë Rrethit Kavajë.

Cështjet penale të gjykuara në shkallë të dytë mbi ankimin e prokurorit, i kemi ndarë sipas rretheve gjyqësore, objektit gjykimit, rastet e pranuar si dhe ato për të cilat prokurorët kanë deklaruar heqjen dorë nga ankimi.

Të ndara sipas këtij grupi, qëndrimit të prokurorëve të kësaj prokurorie dhe vendimarrjes së gjykatës apelit, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prokurorit	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
Gjyk them e objekte tjera	151	115	19	289
Mas sigurimi	41	16	2	59
Pranuar ankimi	--	--	--	--
Hequr dorë Autorizuar	17	18	2	37
Rekurse	116	71	6	193

Objekt i ankimeve të ushtruara nga prokurorët kanë patur kundërshtimin e vendimeve të gjykatave të rrethit gjyqësor në lidhje me themelin e çështjeve, për deklarimin fajtor, cilësimin ligjor të veprës penale, llojin dhe masën e dënimit dhënë të pandehurve. Një numër i konsiderueshëm i ankimeve i përkthet aplikimit të dënimeve alternative të dhënë nga gjykatat e faktit për të cilat prokurorët nuk kanë qenë dakord dhe kanë ushtruar ankim në shkallë të dytë.

Ankimet e përkrahura. Sikurse rezulton nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se

është përkrahur ankimi për rreth 85 % të rasteve, nga 289 ankime janë përkrahur 252 ankime dhe është deklaruar heqja dorë vetëm në 37 raste. Nga 252 rastet e përkrahura të ankimit të prokurorëve rezulton se nga ana e Gjykatës Apelit Durrës, janë pranuar 71 prej tyre që përbën rreth 28 % të ankimeve të pranuar. Në krahasim me një vit më parë rezulton rritje e ankimeve të pranuar të prokurorëve nga Gjykata e Apelit. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 34 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 27 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 10 ankime Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Rastet e ankimeve të pranuar dhe të përkrahura nga gjykata e apelit Durrës, të ndara sipas rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Ankim Prok i pranuar	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
F. Elezi	5	3	3	11
K. Luli	13	7	2	22
B. Hoti	4	5	-	9
L. Dodaj	7	5	5	8
M. Duda	5	7	3	15
Gjithsej	34	27	10	71

Rastet e mospërkrahjes, heqjes dorë nga ankimi i prokurorëve të shkallës parë, të ndara rretheve gjyqësore dhe për secilin prokuror, treguesit paraqiten si më poshtë;

Hequr dorë nga ankimi Prokurorit	Prok Durrës	Prok Elbasan	Prok Kavajë	Gjithsej
F. Elezi	3	1	--	4
K. Luli	1	1	--	2
B. Hoti	2	5	1	8
L. Dodaj	3	3	-	6
M. Duda	8	7	1	16
Gjithsej	17	18	2	37

Heqjet dorë nga ankimi i prokurorëve. Sikurse rezulton nga treguesit analitikë, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie për këto çështje rezulton se është deklaruar heqja dorë vetëm në 37 raste nga 289 ankime të ushtruara, të cilat zënë reth 13% të totalit ankimeve të ushtruara. Rastet e heqjeve dorë i përkasin 17 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 18 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 2 raste Prokurorisë Rrethir Kavajë. Rezulton rritje e numrit të autorizimeve të prokurorëve të shkallës parë në krahasim me një vit më parë. Duhet thënë se të gjitha autorizimet kanë qenë shprehje e vullnetit të prokurorëve të shkallë parë për përfaqësimin e ankimit në Gjykatën e Apelit, pas njoftimit me shkrim për mospërkrahjen e ankimit të prokurorit në zbatim të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe posacërisht të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014 të Prokurorisë Përgjithshme.

Sikurse konstatohet kryesisht heqjet dorë nga ankimi i përkasin rasteve të kundërshtimit të aplikimit të dënimeve alternative sipas neneve 59, 63 të k.penal apo për masë dënimi. Në përgjithësi të gjitha rastet heqjeve dorë nga ana e prokurorëve ato janë diskutuar paraprakisht me prokuroritë e rretheve gjyqësore dhe drejtuesin e prokurorive, për çdo rast të heqjeve dorë nga ankimi janë respektuar kërkesat e Udhëzimit Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014 të Prokurorit të Përgjithshëm.

Duhet thënë se në mjaft raste ankimet e ushtruara nga ana e prokurorëve të prokurorive të rrethit gjyqësore, dhe sidomos por këto çështje rezultojnë të paargumetuar dhe të pa bazuara në prova dhe në ligj. Kjo problematikë është bërë prezente verbalisht prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorive, pasqyruar në relacionet përkatëse të prokurorëve të apelit. Kostatohet gjithashtu se vetëm për aplikimin e dënimeve alternative apo masë dënimi, për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm apo drejtimit mjetit në mënyrë të parregullt, nga prokuroritë e rretheve është ushtruar një numër i konsiderueshëm ankimesh.



Rekurset e ushtruara. Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e prokurorëve në seancë gjyqësore, apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë në 193 raste, nga 211 rekurse të ushtruara gjatë vitit 2015. Sipas rretheve gjyqësore, rezulton se 116 Rekurse janë ushtruar për rrethin gjyqësor Durrës, 71 Rekurse për rrethin gjyqësor Elbasan dhe 6 Rekurse për rrethin gjyqësor Kavajë. Nga Drejtuesi i kësaj prokurorie në 3 raste është ushtruar Rekursi në Gjykatën e Lartë, ndërsa për rastet e tjera është miratuar qëndrimi dhe praktika për mosushtrim rekursi, konformë kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Për çështjet penale me objekt lirim para kohe sipas nenit 64 të k.penal, ndonëse rezulton i ulët për shkak të veprimit të ligjit për dhënie amnistie, në përgjithësi gjykohen në shkallë të dytë mbi ankimin e prokurorëve ndaj vendimeve të gjykatës faktit që ka pranuar kërkesat e dënuarve për lirim para kohe. Duhet nënvizuar këtu fakti se nga ana e Prokurorisë Apelit janë përkrahur ankimet e prokurorëve për rrëzimin e kërkesës së të dënuarit për lirim para kohe sipas nenit 64 të k.penal. Për këto çështje evidentohet formalizëm në ankimin e prokurorëve, nuk bëhet analizë e kërkesave të ligjit si dhe rrethanave dhe sidomos vecorive të dënuarit objekt gjykimi.

Çështjet me objekt të tjera gjykimi. Këto çështje bëhen objekt gjykimi në gjykatën e apelit kryesisht mbi ankimin e palëve ndaj vendimeve administrative penale të prokurorisë dhe gjykatës rrethit gjyqësor. Çështje të tilla mund të permendim ankimet ndaj vendimit të mosfillimit, pushimit procedimit penal, kërkesat për rivendosje në afat të drejtës ankimit etj.. Këto çështje janë bërë objekt gjykimi në shkallë të dytë mbi ankimin e palëve, prokurorit apo personave të interesuar. Për këto çështje duhet të evidentojmë faktin se nga prokurët e

prokurorive të rretheve gjyqësore në mjaft raste mbahen qëndrime të gabuara, nuk kryen të gjitha veprimet e detyrueshme e të domosdoshme hetimore cka sjellin edhe vendime mosfillimi apo pushimi jo të bazuara në prova dhe ligj. Konstatohet rritje e numrit të çështjeve me këtë objekt gjykimi dhe sidomos e rateve kur nga ana e gjykatave është vendosur shfuqizimi i vendimeve të prokurorëve të shkallës parë për mosfillim apo pushimin e procedimit.

Në punën e tyre të përditshme, prokurorët e apelit i kushtojnë një rëndësi shumë të madhe edhe momentit pas përfundimit të gjykimit të çështjeve që përfaqsohen nga ana e tyre. Cdo prokuror nxjerre problemet ligjore që ka patur në çdo çështje dhe ia bën prezent ato prokurorit të çështjes në prokuroritë e shkallës së parë, ka përpiluar informacione për mosushtim rekursi dhe i ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme në ato raste kur megjithatë gjykata ka vendosur në kundërshtim me kërkesën e tij, krijon bindjen se nuk ka baze ligjore për të ushtruar rekurs, bën urdherat e ekzekutimit për vendimet që duhen ekzekutuar menjëherë si dhe ushtron rekurse në Gjykatën e Lartë, për vendimet me të cilat nuk është dakort. Për ato raste kur nuk kemi qene dakort me vendimin e gjykatës dhe kemi qene të bindur se ekzistonin kriteret ligjore të percaktuara në nenin 432 të K.Pr.Penale, kemi ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë Tirane.

Mbi ekzekutimin e vendimeve penale. Në këtë fazë nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Apelit Durrës, është kryer një volum i konsiderueshëm punë, e cila konsiston jo vetëm në bërjen e urdherave të ekzekutimit, por edhe në përgatitjen e dokumentacionit të nevojshëm që i dërgohet prokurorëve të rretheve me qëllim ekzekutimin e vendimeve të gjykatës që nuk janë me ekzekutim të menjëhershëm, nga prokurorët e ekzekutimeve të vendimeve që ndodhen pranë këtyre prokurorëve.

Nga prokuroret e Prokurorisë së Apelit Durrës, janë nxjerre urdhera ekzekutimi të natyrave të ndryshme, urdhera arrestimi, urdhera lirimi si dhe urdhera ekzekutimi për kalimin nga njëra masë sigurimi në një masë tjetër sigurimi. Urdherat e arrestimit u janë dërguar menjëherë policive gjyqësore të komisariteve përkatëse. Ndërsa urdherat e lirimit janë ekzekutuar nga sektorët juridik për I.E.Vendimeve Penale, bazuar në urdhërat e prokurorit çështjes. Në këto raste është bërë lirimi i menjëhershëm i personave të arrestuar dhe u është njoftuar masë tjetër e sigurimit në rastet kur gjykata ka caktuar masë tjetër sigurimi. Urdherat e ekzekutimit janë nxjere jo vetëm për masat e sigurimit, por edhe për lirimet me kusht si dhe për çështje për të cilat ka përfunduar gjykimi në themel.

Për çështjet e gjykuara në themel, për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve të formës së prërë, janë dërguar për ekzekutim praktikat në prokuroritë e rrethëve përkatëse, brenda afatëve të percaktuara në Urdherin e Prokurorit të Përgjithshëm. Këto praktika janë kryesisht për çështjet e gjykuara në themel, për të cilat është lënë në fuqi vendimi i gjykates shkallës së parë dhe të pandehurit janë dënuar me burgim, por nuk kanë patur masë sigurimi apo kanë patur masa, të cilat nuk i pergjigjen llojit të dënimit të dhënë, si dhe për gjykimet me objekt lirim me kusht në rastet kur është ndryshuar vendimi dhe është rrefuzuar kërkesa e të dënuarit nga gjykata e apelit.

### Ngarkesa dhe treguesit e punës për secilin Prokuror

1. **Prokurori Moisi Duda**. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2016 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 358 çështjeve penale, nga të cilat 18 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2015. Nuk ka përfunduar gjykimin për 17 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, nga të cilat 7 çështje mbi ankimin e prokurorit dhe 10 çështje mbi ankimin e të pandehurve. Sipas objektit të gjyimit, rezultojnë 293 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 65

cështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 93 cështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 80 cështje themeli dhe 13 cështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Nga ana e prokurorit Moisi Duda, gjatë kësaj periudhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 16 raste të cilat i përkasin 8 raste Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Durrës dhe 7 raste Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në cdo rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe drejtuesin e kësaj prokurorie. Për këto raste janë respektuar me korrektësi kërkesat e Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga 77 ankimet të prokurorëve shkallës parë dhe të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga Gjykata e Apelit rreth 20 % e tyre, gjithsej në 15 raste, 14 raste për cështjet me objekt themelin e tyre dhe 1 rast ankimi për vleftësim e caktim mase sigurimi. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 5 Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Durrës, 7 Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Elbasan dhe 3 Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Kavajë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 55 cështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 30 Rekurse për rrethit Durrës, 23 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 2 rekurse Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Kavajë.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, është paraqitur relacion për mosushtim rekursi në Gjykatën e Lartë konformë kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Prokurori Moisi Duda, është karakterizuar nga ndjenja e përgjegjësise, korrektësi dhe përkushtimi ne punë. Gjatë këtij viti ai ka përballuar ngarkese te madhe dhe me probleme juridike te çeshtjeve, te cilave u ka dhene gjithmonë zgjidhje të drejte ligjore. Perfaqsimi ne gjykim rezulton, profesional dhe ligjor, ka paraqitur ne çdo rast konkluzionet me shkrim para gjykates dhe të argumentuara. Nuk rezulton që seancat gjyqësore të jenë shtyrë për mosparaqitje të këtij prokurori në gjykim. Diskuton dhe analizon në cdo rast problematikat e çështjeve me prokurorët e shkallës parë, drejtuesin e prokurorisë për dhënien e zgjidhjeve sa më ligjore e profesionale.

**2. Prokurori Ludovik Dodaj.** Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2016 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 357 çështjeve penale, nga të cilat 19 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2015. Nuk ka përfunduar gjykimin për 13 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, nga të cilat 2 çështje mbi ankimin e prokurorit dhe 11 çështje mbi ankimin e të pandehurve. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 294 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 63 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 85 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 69 çështje themeli dhe 16 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Nga ana e prokurorit Ludovik Dodaj, gjatë kësaj periudhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës

parë për 6 raste të cilat i përkasin 3 raste Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Durrës dhe 3 raste Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në cdo rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe drejtuesin e kësaj prokurorie. Për këto raste janë respektuar me korrektësi kërkesat e Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga 79 ankimet të prokurorëve shkallës parë dhe të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga Gjykata e Apelit rreth 18 % e tyre, gjithsej në 14 raste, 10 raste për çështjet me objekt themelin e tyre dhe 2 raste të ankimeve për vleftësim e caktim mase sigurimi. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 7 Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Durrës, 5 Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Elbasan dhe 2 Prokurorisë Rrethit Gjiqësor Kavajë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 40 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 22 Rekurse për rrethit Durrës, 18 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, është paraqitur relacion për mosushtrim rekursi në Gjykatën e Lartë konformë kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Prokurori Ludovik Dodaj, karakterizohet nga ndjenja e përgjegjësisë, korrektësi dhe përkushtimi në punë. Ky prokuror

ka përballuar ngarkese te madhe dhe me probleme juridike te çeshtjeve, te cilave është përpjekur ti japë gjithmone zgjidhje te drejte juridike. Evidentohet per perfaqsimin e proçeseve me probleme ne raport me provat dhe gjykimin e tyre te pjesshem ne gjykimin ne shkalle te dyte. Duhet të punojë më shumë në drejtim të evidentimit të problematikës dhe shkeljeve ligjore të kryera nga ana e prokurorëve të shkallës parë. Nuk rezulton që seancat gjyqësore të jenë shtyrë për mosparaqitje të këtij prokurori në gjykim. Diskuton dhe analizon në cdo rast problematikat e çështjeve me prokurorët e shkallës parë, drejtuesin e prokurorisë për zgjidhjen ligjore të çështjeve.

3. **Prokurori Bujar Hoti**. Nga ky prokuror gjatë periudhës 8 mujore të vitit 2016 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 214 çështjeve penale, nga të cilat 11 çështje kanë qenë të mbartura nga viti 2015. Nuk ka përfunduar gjykimin për 5 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, nga të cilat 2 çështje mbi ankimin e prokurorit dhe 3 çështje mbi ankimin e të pandehurve. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 176 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 38 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 49 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 40 çështje themeli dhe 9 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Nga ana e prokurorit Bujar Hoti, gjatë kësaj periudhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 8 raste të cilat i përkasin 2 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 5 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 1 rast prokurorisë Kavajë. Heqjet dorë nga ky prokuror në përgjithësi janë diskutuar me prokurorët dhe drejtuesin e kësaj prokurorie sipas kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014. Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e

gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga 44 ankimet të prokurorëve shkallës parë dhe të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga Gjykata e Apelit rreth 20 % e tyre, gjithsej në 9 raste, 8 raste për çështjet me objekt themelin e tyre dhe 1 rast ankimi për vleftësim e caktim mase sigurimi. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 4 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 5 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 32 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 10 Rekurse për rrethit Durrës, 4 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 1 Prokurorisë Rrethit Kavajë. Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, është paraqitur relacion për mosushttrim rekursi në Gjykatën e Lartë konformë kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Prokurori Bujar Hoti, për periudhën e mësipërme ka përbulluar ngarkese të konsiderueshme pune, për çështje me probleme juridike të cilave në përgjithësi u ka dhënë zgjidhje të drejte juridike në përputhje me provat dhe bindjen e tij. Evidentohet për perfaqsimin e proçeseve me probleme në raport me provat dhe gjykimin e tyre të pjeshem në shkallë të dyte. Perfaqsimi në gjykim rezulton të jetë ligjor, në çdo rast konkluzionet janë dhënë me shkrim para gjykatës. Nuk rezulton që të jenë shtyrë seancat gjyqësore për mosparaqitje të këtij prokurori. Duhet të analizojë e diskutojë me prokurorët e çështjeve dhe drejtuesin e prokurorisë apelit, problematikat që dalin nga nga ankimet e prokurorëve dhe shkaqet e mos përkrahjes së ankimeve.



4. **Prokurori Kujtim Luli**. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2016 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 334 çështjeve penale. Nuk ka përfunduar gjykimin për 8 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017, nga të cilat 3 çështje mbi ankimin e prokurorit dhe 5 çështje mbi ankimin e të pandehurve. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 281 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 53 çështje me objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 80 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 68 çështje themeli dhe 12 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Nga ana e prokurorit Kujtim Luli, gjatë kësaj periudhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 2 raste të cilat i përkasin 1 rast Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 1 rast Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në cdo rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë dhe drejtuesin e kësaj prokurorie. Për këto raste janë respektuar me korrektësi kërkesat e Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga 78 ankimet të prokurorëve shkallës parë dhe të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga Gjykata e Apelit rreth 28 % e tyre, gjithsej në 22 raste, 18 raste për çështjet me objekt themelin e tyre dhe 4 raste të ankimeve për vleftësim e caktim mase sigurimi. Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në

prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 55 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 34 Rekurse për rrethit Durrës, 20 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 1 rekurs Prokurorisë Rrethit Kavajë. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 13 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 7 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 2 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni 432 i K.Pr.Penale, është paraqitur relacion për mosushttrim rekursi në Gjykatën e Lartë konformë kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

Prokurori Kujtim Luli, karakterizohet nga ndjenja e lartë e përgjegjësise, e korrektësisë dhe përkushtimi ne pune e pasqyruar edhe në rezultat e arritura. Nga ky prokuror është përballuar ngarkese të madhe dhe me probleme juridike te çështjeve, te cilave u ka dhënë gjithmonë zgjidhje te drejte juridike. Përfaqsimin në gjykim rezulton të jetë i arsyetuar, profesional dhe ligjor. Nga ky prokuror janë paraqitur ne çdo rast konkluzionet me shkrim para gjykates, të arsyetuar dhe me praktikë të gjykatës lartë. Dallohet për evidentimin e problematikave dhe qëndrimeve të prokurorëve të shkallës parë, gjykatave të rretheve gjyqësore si dhe të gjykatës apelit. Diskuton dhe analizon në cdo rast problematikat e çështjeve me prokurorët e shkallës parë, drejtuesin e prokurorisë apelit për dhënien e zgjidhjeve sa më ligjore e profesionale.

5. **Prokurori Ferdinand Elezi**. Nga ky prokuror gjatë periudhës janar-dhjetor të vitit 2016 është përfaqësuar akuza në gjykimin e 237 çështjeve penale. Nuk ka përfunduar gjykimin për 4 çështje themeli të cilat janë mbartur për vitin 2017 dhe kanë ardhur për gjykim mbi ankimin e të pandehurve. Sipas objektit të gjykimit, rezultojnë 189 çështje me objekt gjykimin e themelit të çështjes dhe 48 çështje me

objekt vleftësim, caktim, zëvendësim mase sigurimi. Nga ky prokuror është përfaqësuar gjykimi i ankimeve të prokurorëve të shkallës parë për 40 çështje, repektivisht ka përfaqësuar ankimet e prokurorëve për 31 çështje themeli dhe 9 çështje mbi ankimin e prokurorëve për vleftësim e caktim mase sigurimi.

Nga ana e prokurorit Ferdinand Elezi, gjatë kësaj periudhe është deklaruar heqja dore nga apeli i prokurorit të shkallës parë për 4 raste të cilat i përkasin 3 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës dhe 1 raste Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan. Heqjet dorë nga ky prokuror në cdo rast janë diskutuar me prokurorët e prokurorive të shkallës parë. Për këto raste janë respektuar me korrektësi kërkesat e Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014. Sikurse rezulton nga të dhënat e mësipërme në përgjithësi kërkesat e prokurorit paraqitur Gjykatës Apelit Durrës, janë konsideruar të drejta nga ana e gjykatës dhe janë pranuar. Në raste kur nga ana e gjykatës apelit nuk janë vlerësuar kërkimet e prokurorit, nga ky prokuror është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë.

Nga 36 ankimet të prokurorëve shkallës parë dhe të përkrahura nga ky prokuror, rezulton se janë pranuar nga Gjykata e Apelit rreth 30 % e tyre, gjithsej në 11 raste, 8 raste për çështjet me objekt themelin e tyre dhe 3 raste të ankimeve për vleftësim e caktim mase sigurimi. Rastet e pranimit të ankimeve të ushtruara nga prokurorët, i përkasin 5 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Durrës, 3 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Elbasan dhe 3 Prokurorisë Rrethit Gjyqësor Kavajë.

Në rastet kur nga Gjykata e Apelit Durrës nuk janë pranuar kërkimet e këtij prokurori apo kur vendimi i kësaj gjykate nuk është vlerësuar i bazuar në prova dhe ligj, është ushtruar Rekurs në Gjykatën e Lartë për 22 çështje të cilat sipas rretheve gjyqësore i përkasin; 16 Rekurse për rrethit Durrës, 4 Rekurse rrethit gjyqësor Elbasan dhe 2 për rrethin gjyqësor Kavajë. Për rastet e tjera kur nga Gjykata e Apelit nuk është pranuar kërkesa e këtij prokurori në gjykimin në apel, dhe është vlerësuar se nuk janë rastet e parashikuara nga neni

432 i K.Pr.Penale, është paraqitur relacion për mosushttrim rekursi në Gjykatën e Lartë konformë kërkesave të Udhëzimit të Prokurorit të Përgjithshëm Nr 1 datë 14.11.2008 dhe të Qarkores Nr 1735 datë 26.05.2014.

**Konkluzione, objektiva e rekomandime.** Prokuroria e Apelit Durrës, ka mbajtur marrëdhënie korrekte dhe ligjore, me organet e tjera, në raport me kryerjen e detyrave të saj, Kushtetuese dhe ligjore. Marrëdhënie korrekte dhe ligjore prokuroria e apelit ka patur me Gjykatën e Apelit dhe Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore. Me prokurorët e shkallës parë janë diskutuar vazhdimisht çështjet objekt gjykimi, problematikat që janë hasur dhe ecuria e çështjeve.

Prokurorët e kësaj prokurorie kanë patur pjesmarrje të rregullt në seanca gjyqësore, nuk ka patur asnjë çështje, për asnjë prokuror, që të shtyhet, për shkak të mosparaqitjes së prokurorit në gjykim. Prokurorët shkojnë të përgatitur në gjykim dhe në çdo rast i paraqesin gjykatës konkluzione me shkrim.

Pavaresisht punës së deritanishme është e domosdoshme përmirësimi i saj për vitin 2017 e në vazhdim për realizimin e veprimtarisë të ushtrimit ndjekjes penale dhe përfaqësimit akuzës në gjykim në mënyrë sa më të efektshme dhe me rezultate më të mira.

Gjatë këtij viti nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie janë bërë përpjekje të vazhdueshme për të përfaqësuar akuzën penale në gjykim në shkallë të dytë në mënyrë sa më profesionale dhe të efektshme, bazuar në kërkesat e ligjit dhe provat që janë administruara në çdo çështje penale.

Jo në pak raste konstatohen ankime të cilat ushtrohen formalisht dhe janë të pa argumentuara nga ana e prokurorëve të shkallës parë, çka ndikon drejtpërdrejtë edhe në qëndrimin, punën dhe rezultatet në gjykimin e çështjeve edhe në shkallë të dytë.

Problem shqetësues mbetet veprimtaria hetimore e prokurorëve dhe sidomos e policisë gjyqësore në drejtim të

marrjes dhe administrimit të provave, të respektimit të kërkesave të ligjit procedural dhe formalizimit të kësaj veprimtarie në akte procedurale. Janë evidentuar mjaft raste të vendimeve të mosfillimit apo të pushimit të procedimit penal pa kryer veprimet e nevojshme dhe të domosdoshme hetimore cka ka sjellë vendimarrje të gabuar.

Kërkohet në mënyrë të detyrueshme rritja e nivelit profesional dhe sidomos të ballafaqimit dhe të zbatimit të praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese.

Rritja e forcës arsyetuese dhe përgatitje sa më serioze, për çdo çështje e procedim, pamvarësisht akuzës dhe rëndësisë në gjykimin në shkallë të dytë.

Duhet të rritet forca arsyetuese dhe ligjore në Rekursin e ushtruar në Gjykatën e Lartë.

Bashkëpunim i vazhdueshëm me prokurorët e shkallës së parë për problematikat e çështjes, mënyrën e zgjidhjes, verifikimin e pretendimeve, sqarimin e rrethanave etj..

Këto ishin disa nga treguesit e punës së prokurorisë së Apelit Durrës, për vitin 2016, që u munduan të trajtojnë në mënyrë të përbledhur në këtë material. Duke vlerësuar atë si jo të plotë, mirëpresim pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet tuaja.

Durrës, më 23.02.2017.

**DREJTUESI I PROKURORISË APELIT**  
**Ferdinand ELEZI**